



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 74 Prot

Tiranë, më 8-1 2015

URDHËR

Nr. 8 datë 07-01 2015

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI KONTROLLIN E GJAKUT PËR AGJENTËT
INFEKTIV TË TRANSMETUESHËM ME ANË TË TRANSFUZIONIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 25 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 "Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe rekomandimeve të Komitetit Kombëtar të Gjakut,

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullores "Mbi kontrollin e gjakut për agjentët infektiv të transmetueshëm me anë të transfuzionit".
2. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, bankat e gjakut në rrethe dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij urdhëri.
3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 361 datë 10.06. 2009 Për miratimin e rregullores "Mbi kontrollin e gjakut për agjentët infektiv të transmetueshëm me anë të transfuzionit " shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ILIR BEQAJ